

# Tabelat e Burim-Përdorimeve 2017

**Tiranë, më September 30, 2020:** INSTAT publikon tabelat e konsoliduara të Burim-Përdorimeve (TBP), për vitin 2017, të cilat ofrojnë një pamje të detajuar të ekonomisë. Ato janë një instrument i rëndësishëm në analizën dhe krijimin e modeleve statistikore. Këto tabela përshkruajnë; burimet dhe përdorimet e produkteve si dhe lidhjet ndërdegësore në ekonomi.

Burimet dhe Përdorimet gjithsej me çmime korrente në vitin 2017, u vlerësuan 3.425.164 milionë lekë, duke shënuar një rritje në terma nominalë prej 5,1 %, krahasuar me vitin 2016.

Prodhimi përfaqëson 73,2 % të burimeve gjithsej me çmime korrente, ku të mirat materiale zënë 48,3 % ndërsa shërbimet 51,7 %. Importi përfaqëson 21,1 % të burimeve gjithsej ku të mirat materiale të importuara përbëjnë 66,4 % ndërsa shërbimet 33,6 %.

Konsumi ndërmjetës përfaqëson 33,6 % të përdorimeve gjithsej me çmime korrente, ku të mirat materiale zënë 69,4 % ndërsa shërbimet 30,6 %. Kërkesa finale përfaqëson 66,4 % të përdorimeve gjithsej ku kërkesa për të mira materiale zë 59,9 % dhe për shërbime 40,1 %.

**Tab. 1 Tabela e Burimeve dhe Përdorimeve me çmime korrente për vitin 2017, në milionë lekë**

Aktivitetet (NVE)	Të mira material	Shërbime	Prodhimi gjithsej sipas produkteve 3=1+2	Importet (CIF)	MTT*	Burime gjithsej 6=3+4+5	Të mira materiale	Shërbime	Konsumi ndërmjetës sipas produkteve 9=7+8	Kërkesa Finale	Përdorime gjithsej 11=9+10
Produkte (NP)	1	2		4	5		7	8		10	
<b>Të mira materiale [1-43]</b>	1.204.242	5.603	1.209.845	480.120	470.313	2.160.278	567.413	231.947	799.360	1.360.918	2.160.278
<b>Shërbime [45-98]</b>	60.014	1.236.169	1.296.183	242.860	(274.158)	1.264.885	86.190	265.987	352.177	912.708	1.264.885
<b>Gjithsej</b>	1.264.256	1.241.773	2.506.028	722.980	196.155	3.425.164	653.603	497.934	1.151.537	2.273.626	3.425.164
<b>Vlera e shtuar</b>							603.597	687.606	1.291.203		

\* Marzhet e tregtisë, transportit dhe taksat neto mbi produktet

## Tabela e Burimeve

Kjo tabelë ofron një vlerësim për burimet e të mirave materiale dhe shërbimeve të prodhuara në vend dhe atyre të importuara. Sipas rreshtave paraqiten burimet e produkteve, ndërsa sipas kolonave aktivitetet ekonomike që i prodhojnë këto produkte. Klasifikimi i çdo njësie ekonomike bazohet në produktin që zë pjesën më të madhe të prodhimit të saj.

Për publikim 30/09/2020

**Tab. 2 Tabela e Burimeve me çmime bazë dhe transformimi me çmime korrente, në milionë lekë**

Aktivitetet (NVE) *	A	B-E	F	G-I	J	K	L	M-N	O-Q	R-U	Prodhimi sipas produkteve	Importet (CIF)	MTTT**	Burimet gjithsej
Produkte (NP) *	Prodhimi sipas aktiviteteve (NVE), me çmime bazë													
A	299.388	-	-	-	-	-	-	-	-	-	299.388	24.455	63.944	387.788
B-E	109.201	390.250	51.461	279	17	-	-	-	209	20	551.437	455.539	398.514	1.405.490
F	-	2.985	350.955	3.128	424	-	123	1.384	-	20	359.020	126	7.855	367.001
G-I	271	15.778	14.591	424.812	823	-	634	2.574	740	761	460.984	111.088	(283.433)	288.639
J	-	211	179	821	122.765	-	-	3.214	62	653	127.905	29.181	4.184	161.271
K	-	-	-	899	-	62.723	-	18	-	-	63.640	6.549	-	70.189
L	-	374	17.663	467	-	-	100.233	192	-	-	118.929	-	124	119.053
M-N	1.663	935	8.060	3.150	1.751	-	191	190.491	6.305	818	213.363	31.089	3.236	247.688
O-Q	-	-	99	124	-	-	8	129	231.446	1.092	232.897	25.046	132	258.075
R-U	-	180	10	133	2	-	-	176	128	77.835	78.465	39.906	1.600	119.971
<b>Prodhimi sipas aktiviteteve</b>	<b>410.524</b>	<b>410.714</b>	<b>443.018</b>	<b>433.812</b>	<b>125.782</b>	<b>62.723</b>	<b>101.189</b>	<b>198.178</b>	<b>238.890</b>	<b>81.198</b>	<b>2.506.028</b>	<b>722.980</b>	<b>196.155</b>	<b>3.425.164</b>


\* Grupimi i aktiviteteve dhe produkteve bazuar në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2) dhe Nomenklaturën e Produkteve (NP 2008)

\*\* Marzhet e tregtisë, transportit dhe taksat neto mbi produktet

Komponentët e tabelës së burimeve për vitin 2017, krahasuar me vitin 2016, shfaqen si më poshtë:


- Prodhimi vendas, i cili përbën peshën kryesore të tabelës së burimeve u rrit me 4,4 %;
- Importet e të mirave materiale dhe shërbimeve u rritën me 7,1 %;
- Taksat neto mbi produktet u rritën me 8,2 %.

**Fig. 1 Struktura e Burimeve, në %**



Përsa i përket strukturës së tabelës së burimeve sipas origjinës (Fig.2) me çmime bazë, *prodhimi vendas* zë 77,6 % të burimeve, ndërsa *importet* zënë 22,4 %. Depërtimi më i madh i të mirave materiale dhe shërbimeve të importuara vërehet tek produktet *Industriale* me 45,2 %.

**Fig. 2 Struktura e Burimeve me çmime bazë, sipas origjinës së produkteve, në %**



Në vitin 2017, peshën më të madhe në strukturën e prodhimit me çmime bazë e zënë produktet e *Industrisë* me 22,0 %, pasuar nga *Tregtia, transporti, akomodimi e shërbimi ushqimor* me 18,4 % dhe *Ndërtimi* me 14,3 %.

Në strukturën e produkteve të importuara, peshën më të madhe e zënë produktet e *Industrisë* me 63,0 %, ndjekur nga *Tregtia, transporti, akomodimi e shërbimi ushqimor* me 15,4 %.

**Tab. 3 Struktura e Burimeve sipas origjinës së produkteve**

Produktet (NP)	Prodhimi		Importe	
	mln	%	mln	%
A Bujqësia, pyjet dhe peshkimi [1-3]	299.388	11,9	24.455	3,4
B-E Industria gjithsej [5-39]	551.437	22,0	455.539	63,0
F Ndërtimi [41-43]	359.020	14,3	126	0,0
G-I Tregtia, Transporti, Akomodimi dhe shërbimit ushqimor [45-56]	460.984	18,4	111.088	15,4
J Informacioni dhe komunikacioni [58-63]	127.905	5,1	29.181	4,0
K Shërbime financiare dhe të sigurimit [64-66]	63.640	2,5	6.549	0,9
L Shërbime të pasurive të paluajtshme [68]	118.929	4,7	-	0,0
M-N Shërbime shkencore, Profesionale, Administrative, Mbështetëse [69-82]	213.363	8,5	31.089	4,3
O-Q Administrata publike, Arsimi, Shëndetësia, Aktivitete të punës sociale [84-88]	232.897	9,3	25.046	3,5
R-U Arte, Argëtim dhe çlodhje, Aktivitete të tjera shërbimi [90-98]	78.465	3,1	39.906	5,5
Burimet gjithsej me çmime bazë	2.506.028	100,0	722.980	100,0

**Tabela e Përdorimeve**

Në tabelën e përdorimeve paraqiten drejtimet kryesore të përdorimit të burimeve në ekonominë e vendit, Ato paraqiten në formën e përdorimit si: *Konsum Ndërmjetës, Konsum Final i Familjeve, Konsum Final i Administratës Publike, Formimi Bruto i Kapitalit dhe Eksporte*, Kjo tabelë paraqet në kolona strukturën e inputeve për çdo degë të aktivitetit ekonomik dhe në rreshta përdorimin e të mirave materiale dhe shërbimeve të disponueshme.

Komponentët e tabelës së Përdorimeve për vitin 2017, krahasuar me vitin 2016 shfaqen si më poshtë:

- Konsumi final, i cili përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi u rrit me 3,2 %;
- Konsum Ndërmjetës u rrit me 3,7 %;
- Komponenti i Formimit bruto të kapitalit fiks u rrit me 5,3 %;
- Eksportet e të mirave materiale dhe shërbimeve u rritën me 14,1 %.


**Tab. 4 Tabela e Përdorimeve me çmime korrente, në milionë lekë**

Aktivite (NVE)	A	B-E	F	G-I	J	K	L	M-N	O-Q	R-U	KN* sipas produkteve	SHKF** P3_S13-14	FBKF*** P51-52	Eksporte (FOB) P6	Përdori me çmime korrente
Produkte (NP)	Konsumi ndërmjetës i industrive (NVE)														
<b>A</b>	84.267	13.294	2.147	9.112	43	5	73	464	317	172	109.895	260.483	3.174	14.236	387.788
<b>B-E</b>	25.895	189.900	201.919	84.516	31.998	2.188	1.203	40.278	31.238	9.952	619.087	548.225	91.631	146.547	1.405.490
<b>F</b>	347	3.143	46.502	4.434	2.161	2	5.692	3.557	4.000	541	70.378	3.857	291.864	901	367.001
<b>G-I</b>	2.652	8.964	5.359	28.992	4.122	990	110	12.706	6.760	4.439	75.093	88.688	-	124.857	288.639
<b>J</b>	9	2.649	1.481	4.103	25.573	4.855	289	6.832	5.937	6.142	57.870	54.359	1.769	47.272	161.271
<b>K</b>	312	7.729	4.951	13.103	1.065	3.940	6.036	1.369	1.998	4.162	44.666	18.334	-	7.189	70.189
<b>L</b>	234	3.877	2.594	5.688	2.008	2.535	99	7.701	666	1.867	27.269	91.784	-	-	119.053
<b>M-N</b>	1.843	6.782	36.056	32.391	10.565	8.887	446	26.565	2.069	8.845	134.451	13.597	38	99.602	247.688
<b>O-Q</b>	-	153	304	431	209	530	2	1.070	2.434	3.662	8.794	238.143	-	11.138	258.075
<b>R-U</b>	0	228	15	876	128	45	1	5	2.571	165	4.034	78.144	-	37.793	119.971
<b>KN sipas aktiviteve</b>	115.558	236.719	301.326	183.647	77.872	23.978	13.951	100.547	57.992	39.947	1.151.537	1.395.615	388.476	489.536	3.425.164
<b>Vlera e Shtuar</b>	294.966	173.995	141.692	250.165	47.910	38.745	87.238	97.631	180.898	41.251	1.354.491				

\* Konsumi ndërmjetës  
 \*\*Konsumi Final i Familjeve dhe Administratës Publike  
 \*\*\* Formimi Bruto i Kapitalit Fiks dhe Ndryshimi i Gjendjeve


Gjatë vitit 2017, struktura e tabelës së përdorimit të të mirave materiale dhe shërbimeve të disponueshme nga përdoruesit brenda dhe jashtë territorit të vendit (Fig.3) paraqitet e tillë: 33,6 % është përdorur për *konsum ndërmjetës* në proceset e prodhimit, 40,7 % është përdorur për *konsum final nga familjet dhe administrata publike*, 11,3 % është përdorur për *formim bruto të kapitalit* dhe 14,3 % është *eksportuar*.

**Fig. 3 Struktura e Tabelës së Përdorimeve, në %**



Në tabelën e përdorimeve (Fig.4), të mirat materiale përfaqësojnë 63,1 % të përdorimeve gjithsej, ndërsa shërbimet 36,9 %. Përdorimi i të mirave materiale zë peshën kryesore në *formimin bruto të kapitalit* me 99,5 % dhe në *konsumin ndërmjetës* me 69,4 %.

**Fig. 4 Struktura e Përdorimeve sipas komponentëve, në %**



Në vitin 2017, peshën më të madhe në strukturën e përdorimeve të brendëshme me çmime tregu (ku përfshihet konsumi ndërmjetës, konsum final i familjeve dhe administratës publike, formim bruto të kapitalit fiks dhe ndryshim gjendje), e zënë produktet e *Industrisë* me 35,9 %, pasuar nga *Ndërtimi* me 16,6 % dhe *Bujqësia, pyjet dhe peshkimi* me 14,8 %.

Në strukturën e produkteve të eksportuara, peshën më të madhe e zënë produktet e *Industrisë* me 29,9 %, ndjekur nga *Tregtia, transporti, akomodimi e shërbimi ushqimor* me 25,5 %.

**Tab. 5 Struktura e Përdorimeve sipas destinacionit**

Produktet (NP)		Përdorim i brendshëm		Eksport	
		mln	%	mln	%
A	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi [1-3]	263.657	14,8	14.236	2,9
B-E	Industria gjithsej [5-39]	639.857	35,9	146.547	29,9
F	Ndërtimi [41-43]	295.721	16,6	901	0,2
G-I	Tregtia, Transporti, Akomodimi dhe shërbimit ushqimor [45-56]	88.688	5,0	124.857	25,5
J	Informacioni dhe komunikacioni [58-63]	56.128	3,1	47.272	9,7
K	Shërbime financiare dhe të sigurimit [64-66]	18.334	1,0	7.189	1,5
L	Shërbime të pasurive të paluajtshme [68]	91.784	5,1	-	0,0
M-N	Shërbime shkencore, Profesionale , Administrative, Mbështetëse [69-82]	13.635	0,8	99.602	20,3
O-Q	Administrata publike, Arsimi, Shëndetësia, Aktivitete të punës sociale [84-88]	238.143	13,3	11.138	2,3
R-U	Arte, Argëtim dhe çlodhje, Aktivitete të tjera shërbimi [90-98]	78.144	4,4	37.793	7,7
Përdorimet gjithsej me çmime korrente		1.784.091	100,0	489.536	100,0

# Metodologjia

## Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e TBP-ve mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), Ndërtimi i TBP-ve kërkon një numër i madh të dhënash në një nivel shumë të detajuar, Për më tepër lidhur me metodologjinë e përpilimit të TBP, referojuni adresës së mëposhtme:

<http://www.instat.gov.al/al/publications/librat/2015/tabela-e-burim-p%C3%ABrdorimeve,-2009-2011.aspx>

[http://www.instat.gov.al/media/333404/part\\_d-sut\\_compilation\\_albania.pdf](http://www.instat.gov.al/media/333404/part_d-sut_compilation_albania.pdf)

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare janë: - Nomenklatura e veprimtarive ekonomike (NVE Rev,2), - Nomenklatura e produkteve (NP 2008); - Klasifikimi i konsumit individual sipas përdorimit (COICOP); - Klasifikimi i shpenzimeve të qeverisë sipas funksionit (COFOG),

## Burimet e të dhënave

Për vlerësimet e TBP-ve përdoret informacioni i siguruar nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative, Të dhënat e përdorura mund të jenë prodhim statistikor i vetë INSTAT ose i institucioneve të ndryshme kombëtare si Ministritë, Drejtoritë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore etj, Duke krahasuar këto burime me njëra-tjetrën, arrihet të prodhohet një pamje e vetme e ekonomisë, e cila është gjithëpërfshirëse, koherente dhe tërësisht e integruar,

Burimet statistikore përfshijnë të dhënat e siguruar nga regjistrime dhe anketa të ndryshme mbi njësitë ekonomike ose familjet, ndër të cilat mund të përmendim: Regjistri i Ndërmarrjeve; Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve; Anketa e Tregtisë me Pakicë; Anketa e Buxhetit të Familjeve; Anketa të Statistikave të Çmimeve, Statistika të bujqësisë dhe mjedisit, etj,

Burimet administrative përfshijnë të dhëna administrative të mbledhura nga institucione të tjera për qëllime të ndryshme, ndër të cilat mund të përmendim: Pasqyrat financiare vjetore; Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH); Bilanci i Pagesave; Statistika fiskale të administratës publike; Statistika të tregtisë së jashtme; Libri i shitjeve dhe i blerjeve etj,

## Procesi i Balancimit

Procesi i balancimit është një proces shumë i rëndësishëm në tabelat e burim – përdorimeve, Pasi është bërë një përpunim i detajuar për secilin komponent duhet që gjithë burimet e një vendi të shkojnë si përdorime nga ana

tjetër, Në shumicën e rasteve, kjo mund të mos arrihet që në hapin e parë të përdorimit të informacionit, për këtë arsye analiza zhvillohet mbi çdo produkt në këtë sistem,

Përpara se të shikohet mospërputhja në nivel produkti, analizohet mospërputhja statistikore që ekziston ndërmjet metodave të ndryshme të vlerësimit të PBB-së, Në sistemin e tabelave të burim-përdorimeve kjo mospërputhje statistikore eliminohet, si rrjedhim kërkohet që të arrihet ky balancim makroekonomik,

Në rastet kur diferenca ndërmjet burimeve dhe përdorimeve është më e vogël se 5 %, përdoret një balancim automatik i mbështetur mbi shpërndarjen në formë raporti të diferencës ekzistuese, Kur kjo diferencë është ndërmjet 5% dhe 10%, mund të mbështetemi mbi një analizë dhe balancim manual të diferencave, Në rastet kur kjo diferencë është më e madhe se 10 %, atëherë jemi në një situatë, e cila kërkon trajtim në burimin bazë të informacionit, Në këto raste mund të jetë e nevojshme që komponentë të ndryshëm të burimeve apo përdorimeve të kërkojnë një rivlerësim, i cili do të sillte një cikël rrethor të vlerësimeve, Ky cikël do të vazhdojë derisa të gjitha diferencat të jenë brenda intervaleve të pranueshme duke na mundësuar një konsistencë të plotë të vlerësimeve të PBB-së me metoda të ndryshme,

### **Përkufizime**

**Tabelat e Burimeve dhe Përdorimeve me çmime korrente:** Sistemi i TBP-ve me çmime korrente në Shqipëri është i ndërtuar në një nivel prej 88 produktesh dhe 88 aktiviteteve që korrespondojnë me NVE rev, 2 dy shifrore, Analizat janë zhvilluar në nivel produkti sipas klasifikimit NP 2008 2, 4 dhe 6 shifrore, duke mundësuar në këtë mënyrë një pamje të qartë të qarkullimit të produktit në ekonomi, Për ndërtimin e TBP-ve në Shqipëri janë kryer një sërë analizash dhe studimesh për të mundësuar një përdorim sa më eficient të burimeve administrative dhe statistikore, Fokus i veçantë i është vënë kryesisht nivelit të detajimit të të dhënave për të kaluar në një detajim sa më të madh të mundshëm,

**Prodhimi:** Aktiviteti i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale që kombinon burimet në fuqi punëtore, kapital dhe produkte të shërbimeve për të prodhuar produkte ose kryer shërbime, Proceset e pastra natyrore pa ndërhyrjen ose kontrollin e njeriut nuk bëjnë pjesë në prodhim,

**Konsumi ndërmjetës:** Vlera e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit, Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk merret parasysh; ai evidentohet në konsumin e kapitalit fiks,

**Taksat mbi produktet dhe importin:** Taksat mbi produkte janë taksat e pagueshme për njësi të disa mallrave dhe shërbimeve si Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akciza, taksa doganore mbi importet,

**Subvencione në produkte:** Subvencionet në produkte janë pagesat e pakthyeshme që njësitë e administratës publike bëjnë tek ndërmarrjet si një shumë e caktuar parash për njësi të një malli ose shërbimi, Subvencionet në importe konsistojnë në subvencionimin e mallrave ose shërbimeve që bëhen të pagueshme kur malli kapërcen kufirin e territorit ekonomik ose kur shërbimet i janë kaluar njësiteve institucionale rezidente,



**Konsumi Final:** Konsumi Final është një nga komponentët kryesorë të PBB, Ky konsiston në mallrat dhe shërbimet e përdorura nga familjet individuale ose komunitetet dhe llogaritet si shumë e konsumit final të familjeve, konsumit final të administratës publike dhe konsumit final të Institucioneve Jo Fitimprurëse që i Shërbejnë Familjeve (IJFSHs),

**Konsumi final i familjeve:** Llogarit të gjitha mallrat dhe shërbimet që përdoren direkt për të plotësuar kërkesat individuale të familjeve rezidente,

**Konsumi final i administratës publike dhe Institucioneve jo fitim prurëse:** Përmban vlerën e shërbimeve jotregtare të kryera nga administrata publike dhe nga institucionet jofitimprurëse në përfitim të komuniteteve ose grupe familjesh, Kjo llogaritet si diferencë midis prodhimit të administratës publike dhe IJFSHs dhe vlerës së prodhimit tregtar,

**Eksporti neto:** Eksporti neto llogaritet si diferencë midis eksportit të mallrave dhe shërbimeve (fob) dhe importit të mallrave dhe shërbimeve (fob),

**Importi i të mirave materiale dhe shërbimeve** konsiston në vlerën e transaksioneve në të mira materiale dhe shërbime të rezidentëve me jo-rezidentët,

**Formimi Bruto i Kapitalit Fiks:** Konsiston në shpenzimet e kryera për kapitale të reja ose për shpenzime të tjera specifike kryer nga prodhuesit në sende ose shërbime me qëllim që të mbajnë, rritin ose zgjerojnë kapacitetin e tyre prodhues ose që të krijojnë kushte të reja përpunimi në të ardhmen,

**Ndryshimi i gjendjeve:** Përcaktohet si diferencë midis gjendjeve të inventarit dhe në proces të aktiveve qarkulluese në fund dhe në fillim të vitit, Gjendjet përfshijnë: materiale të para dhe materiale të tjera; prodhime, punime shërbime në proces; produkte të gatshme e gjysmë të gatshme, mallra, kafshë, etj,

**Marzhi Tregtar** përcaktohet si diferencë midis çmimit aktual ose të imputuar të një produkti të blerë për rishitje, dhe çmimit që do të paguhej për zëvendësimin e produktit në momentin e shitjes,

**Marzhi i Transportit** përfshin koston e transportit të paguar më vete nga blerësi të përfshira në përdorimet me çmime të blerësit, por jo në prodhimin e prodhuesit me çmime bazë apo në marzhin tregtar,

**Çmime bazë:** Shuma që prodhuesi merr nga blerësi për njësi të produktit apo shërbimit të prodhuar, pa tatimet dhe subvencionet mbi produktin, Çmimi bazë përjashton shpenzimet e transportit të faturuara më vete,

**Çmimet e tregut:** janë çmimet pasi shtohen taksat mbi produktet minus subvencionet mbi produktet,

**Çmime korrente:** Çmimet e periudhës referuese, Ato përfaqësojnë çmimin e paguar për të mirat materiale dhe shërbimet në kohën e prodhimit ose të konsumit,